



Bazuar në Nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), dhe Nenet 19 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucioneve Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Boardi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 29 nëntor 2012, miratoi si në vijim:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT**

### **KAPITULLI I PROVIZIONET E PËRGJITSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është që të vendos standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, të referuara në vijim me *bankat*.

#### **Neni 2 Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me Nenin 3 të ligjit Nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*) dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a. *Mungesë likuiditetit* nënkupton çdo situat, kur banka:
    - i. nuk posedon mjete të mjaftueshme likuide ose ballafaqohen me vështërsi për të siguruar ato në treg, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kur ato maturohen dhe për të përmbushur ndonjë kërkesë të paparashikuar të fondeve nga depozitorët e saj dhe kreditorët tjerë;
    - ii. nuk ka mundësi të financojnë rritjen e mjeteve;
  - b. *Rreziku i likuiditeti* nënkupton mundësin e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit;
  - c. *Kushtet/situata jo të zakonshme* nënkupton ato situata në të cilat ekziston një kërcnim real që mund të sjellë bankën në mungesë të likuiditetit;

- d. *Plani rezervë i likuiditetit* nënkupton dokumentin e hartuar nga banka, në të cilin qartësisht pasqyrohen në politikat dhe procedurat që duhet ndjekur në kushte jo të zakonshme, si dhe procedurat për sigurimin e fondeve të emergjencës;
- e. *Rrjedha neto e parasë* nënkupton diferencën në mes rrjedhjeve hyrëse dhe dalëse të parasë për një periudhë të caktuar kohore, duke reflektuar në rritje apo ulje të sasisë së parasë;
- f. *Maturiteti kontraktual i mbetur* nënkupton periudhën kohore të mbetur deri në përfundimin e afatit të maturimit të mjeteve dhe detyrimeve kontraktore;
- g. *Koncentrimi në burimet e financimit* nënkupton situatën kur një vendimmarrje e vetme ose një faktor i jashtëm i vetëm mund të shkaktojë tërheqje të menjëhershme dhe të konsiderueshme të të fondeve, duke detyruar kështu bankën të ndryshojë ndjeshëm strategjinë e saj të financimit;
- h. *Stress-testi* nënkupton teknikë të menaxhimit të rrezikut për të vlerësuar ndikimin e mundshme të një apo më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare dhe/ose pozicionin e likuiditetit të bankës;
- i. *Depozitorët e mëdhenj* konsiderohen njëzet depozitorët me shumën më të madhe të depozitave në totalin e depozitave të bankës;
- j. *Hendeku i likuiditetit* është diferenca në mes të mjeteve dhe detyrimeve të bankës, sipas intervaleve të maturitetit;
- k. *Shkurtime (Haircut)* është përqindja me të cilën vlera e mjeteve likuide është zvogëluar për qëllime të përlllogaritjes së treguesit të likuiditetit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

## **KAPITULLI II**

### **SISTEMI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË LIKUIDITETIT**

#### **Neni 3**

#### **Sistemi i menaxhimit**

1. Banka krijonë një sistem për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim menaxhimin e mirë të rrezikut të likuiditetit të tyre. Bankat sigurojnë që sistemi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, llojin e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.
2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit pëmban elementet minimale si ne vijim:
  - a. strategjinë dhe politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - b. strukturën organizative për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - c. sistemin e kontrollit të brendshëm;
  - d. sistemin e menaxhimit të informacionit;

- e. stres testi i likuiditetit;
- f. plani rezervë i likuiditetit.

#### **Neni 4** **Strategjia dhe politikat**

1. Bankat hartojnë strategjinë dhe politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit përmban elementet minimale si në vijim:
  - a. objektivat e strategjisë;
  - b. parimet për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - c. metodologjinë e përgjithshme që banka do të zbatojë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në periudhat afatshkrutra dhe afatgjata;
  - d. metodologjinë e përgjithshme dhe vizionin e bankës për të hyrë në shumë tregje dhe burime të financimit dhe;
  - e. politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
3. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit hartohet si një dokument i veçantë ose si një pjesë e planit strategjik të bankës. Strategjia duhet rishikohet në baza të rregullta, së paku në baza vjetore.
4. Politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet rishikuar në baza të rregullta, së paku në baza vjetore dhe minimalisht përmban:
  - a. identifikimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedhë nga produktet dhe operacionet e reja;
  - b. matja e rrezikut të likuiditetit, veçanërisht të:
    - i. pozicionit aktual të likuiditetit, duke përfshirë vlerësimin e mjeteve likuide dhe kolateraleve;
    - ii. parashikimit të rrjedhes hyrëse dhe dalëse të parasë;
    - iii. përputhja në mes të afatit të maturimit të fondeve dhe të burimeve të financimit;
    - iv. koncentrimin e depozitave dhe burimeve të tjera të financimit sipas maturiteteve, llojit dhe strukturës së klientelës;
    - v. përcaktimit e treguesve të likuiditetit dhe përdorimin e tyre në procesin e monitorimit të bankave;
    - vi. përdorimin e *stres test-it* si elementë/pjesë e monitorimit të rrezikut të likuiditetit.
    - vii. vlerësimin periodik të ecurisë së tregjeve ku plotësohen nevojat për likuiditet.

#### **Neni 5** **Struktura organizative për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit**

1. Struktura Organizative e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet qartësisht të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësit e organeve të bankës dhe të definojë detyrat dhe përgjegjësit e pjesës organizative përkatëse në banka, të autorizuar për monitorimin e likuiditetit të bankës dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.

2. Bordi i drejtorëve i bankës, në lidhje me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është përgjegjës që të:
  - a. aprovon strategjin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - b. aprovon politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe monitoron zbatimin e tyre duke përfshirë aprovimin dhe monitorimin e planit kontingjent të likuiditetit;
  - c. rishikon përshtatshmërin e politikave dhe procedurave të adaptuara së paku në baza vjetore;
  - d. rishikon raportet e rrezikut të likuiditetit;
  - e. aprovon limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - f. monitoron efikasësinë e kontrollit të brendshëm, si një pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
  
3. Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut kërkohet që të:
  - a. monitorojë politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe të jap propozime për rishikimin e tyre;
  - b. vlerësoj sistemin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - c. analizojë raportet e ekspozimit të rrezikut të likuiditetit të bankës dhe monitorojë menaxhimin e rrezikut;
  - d. përcaktojë dhe periodikisht rishikojë treguesit e brendshëm të likuiditetit dhe limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - e. përcaktojë përjashtimet e mundshme nga limitet e përcaktuara dhe të caktojë përgjegjësit për zbatimin e këtyre përjashtimeve;
  - f. krijojë procedura dhe metoda për kryerjen e *stres test-it*.
  
4. Përveç, Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, banka mund të krijojë një organ i veçantë (komitet), i cili është përgjegjës për zbatimin e operacioneve të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit përmes monitorimit dhe kontrollimit ditor të rrezikut të likuiditetit.
  
5. Siç është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij Neni, organi i veçantë (komitet) duhet që së paku të:
  - a. aprovojë dhe monitorojë zbatimin e procedurave të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - b. krijojë dhe mbaj sistem efikas për matjen, monitorimin, kontrollimin dhe raportimin e likuiditetit, sipas valutave, të cilat në mënyrë të theksuar ndikojnë në likuiditetin e përgjithshëm të bankës dhe monitorimin e strukturës së mjeteve dhe detyrimeve në Euro dhe valuta të huaja;
  - c. krijojë ambient për përcjelljen e politikës së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - d. të krijojë një sistem adekuat të raportimit tek bordi i drejtorëve dhe komiteti i menaxhimit të rrezikut për çdo mopajtueshmëri me limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - e. përcaktojë instrumentet financiare për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - f. krijojë procedura për përcaktimin dhe monitorimin e stabilitetit të depoziteve;
  - g. krijojë procedurë për vlerësimin e efekteve të produkteve të reja në ekspozimin e rrezikut të likuiditetit;
  - h. monitorojë detyrimet e mundshme dhe ekspozimet e bazuara në operacionet jashtëbilancore të bankave.

## **Neni 6**

### **Sistemi i kontrollit të brendshëm**

1. Banka duhet të vendos procedurat e duhura të kontrollit të brendshëm për të siguruar integrimin e procesit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kuadër të procesit të menaxhimit të rrezikut të përgjithshëm. Kontrolli i brendshëm i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit do të jetë pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm, e krijuar në nivel të bankes.
2. Për qëllime të kontrollit të brendshëm të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, banka duhet të krijojë:
  - a. limitet e aprovimit të rrjedhës së parasë mbi shumat e caktuara dhe monitorimin e pajtueshmërisë me limitet e përcaktuara;
  - b. raportimin e mospajtueshmërive të mundshme me limitet e referuara në nën paragrafin a. të këtij paragrafi;
  - c. verifikimin e rregullt të të dhënave dhe informatave të përdorura gjatë përcaktimit të likuiditetit të bankës;
  - d. sigurimin e përputhshmërisë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të BQK-së, si dhe rregullat e brendshme të bankës.

## **Neni 7**

### **Sistemi i menaxhimit të informacionit**

1. Banka duhet të krijoj një sistem të informacionit për të siguruar me kohë dhe në baza të vazhdueshme matjen, monitorimin, kontrollimin dhe raportimin në procesin e vendim marrjes, me rastin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
2. Sistemi i informacionit kërkohet që së paku të:
  - a. mat dhe monitoroj likuiditetin e bankave dhe rrezikun e likuiditetit në baza ditore dhe në periudhë të caktuar kohore;
  - b. mat dhe monitoron likuiditetin e bankave, sipas valutave të cilat në mënyrë me të theksuar ndikojnë në likuiditetin e përgjithshëm të bankave, në baza individuale dhe të grumbulluara (agreguara);
  - c. monitoron pajtueshmërinë me limitet e vendosura të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - d. sigurojë të dhëna për përcaktimin e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjes së formave raportuese për nevojat e organeve të bankave dhe personave të tjerë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - e. analizo zhvillimet e bazës së depozitave dhe të përcaktoj dhe monitoroj stabilitetin e depozitave
  - f. kryej *stres teste*.

## **Neni 8**

### **Stres testi i likuiditetit**

1. Banka menaxhon likuiditetin jo vetëm në rrethana "normale", por duhet gjithashtu të jetë e përgatitur për të menaxhuar likuiditetin në kushte të stresit.
2. Bankat duhet kryejnë *stres test-in* në baza të rregullta me qëllim të identifikimit dhe kuantifikimit të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, nën kushte/situata normale të aktivitetit ditor si dhe në paraqitjen e ambientit të stresuar. Për këtë qëllim bankat duhet të analizojnë efektet e rrjedhës së parasë, të aftësisë paguese afatshkurtër dhe afatgjatë, përgatitja për të reaguar në kushtet/situatat emergjente dhe vlerësojë aftësinë e rritjes së mjeteve (aseteve) nëpërmjet identifikimit të burimeve të disponueshme të financimit.
3. Shpeshësia me të cilën bankat do të kryejnë stres testet duhet të jetë proporcionale me madhësinë e veprimtarisë së bankave, të ekspozimit të rrezikut të likuiditetit të saj, si dhe me rëndësinë relative të bankave brenda sistemit bankar, por jo më pak se katër herë në vit. BQK-ja mund të kërkojë për bankat kryerjen e stres testeve në periudha më të shpeshta.
4. Bordi i Drejtorëve të Bankës duhet të analizojë rezultatet e *stres testit* të paktën çdo tre muaj për të:
  - a. përmirësuar strategjinë dhe politikën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - b. hartuar dhe përmirësuar kornizën rregullative të nevojshme për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankave;
  - c. zhvilluar plane efektive rezervë.
5. *Stress-test-et* e realizuara nga banka përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë bazuar në faktorë të brendshëm, të skenarëve të bazuar në kushtet e tregut ku banka vepron, si dhe në faktorë makroekonomikë (faktorë të jashtëm).
6. Skenarët për kryerjen e *stress test-ëve* mund të përfshijnë supozimet e mëposhtme:
  - a. tërheqjen e depozitave;
  - b. përkeqësim i mundshëm i aftësisë së kredimarrësve për të shlyer detyrimet, që nënkupton përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë;
  - c. pamundësi të konvertimit me lehtësi dhe pa humbje të konsiderueshme të aktiveve në para të gatshme;
  - d. mundësinë e shlyerjes së parakohshme të detyrimeve në kushtet e ekzistencës së opsioneve kontraktuale që e mundësojnë këtë shlyerje;
  - e. rrezikun operacional dhe shkallën e ndikimit të tij në rritjen e rrezikut të likuiditetit;
  - f. ndryshimet në kushtet ekonomike në sektorët ndaj të cilëve banka është ekspozuar dhe përkeqësimin e ekonomisë në tërësi;
  - g. përkeqësim të funksionimit të tregjeve në të cilat banka operon dhe/ose një reduktim të ndjeshëm të besimit në këto tregje;
  - h. goditjet e papritura të normës së interesit dhe të kursit të këmbimit;

- i. efektin e ndryshimeve të ndjeshme në vlerën e aktiveve të bankës dhe/ose aktiveve të pranuar prej saj si garanci (kolateral);
  - j. kufizimin e pjesëshëm apo të plotë të financimit nga burimet kryesore të financimit, duke përfshirë mundësinë e vazhdueshmërisë së financimit nga banka mëmë;
  - k. ndikimin e zhvillimeve negative ekonomike në shkallë rajonale dhe globale;
  - l. çdo situatë tjetër të mundshme që vlerësohet si burim i mundshëm i rrezikut.
7. Supozimet e renditura në paragrafin 6 të këtij Neni kanë vlerë udhëzuese për bankën, ndërkohë që banka përdor ato situata që përshtaten më mirë me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe peshën e saj në sistemin bankar.
8. Banka përcakton metodologjinë për realizimin e *stress test-eve*, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, e cila përfshinë:
- a. zbatimin, analizën e skenarëve të *stress test-eve* dhe periodicitetin e realizimit të tyre;
  - b. realizimin e *stress test-eve* për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
  - c. dokumentimin dhe rishikimin në mënyrë periodike të supozimeve të përdorura për kryerjen e *stress test-eve*;
  - d. formën dhe periodicitetin e raportimit të rezultateve të *stress test-eve* në strukturat drejtuese;
  - e. veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, mbështetur në rezultatet e *stress test-eve*.

## **Neni 9**

### **Plani rezervë i likuiditetit**

1. Banka duhet të përpiloj plan rezervë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme. Banka duhet të rishikon planin kontingjent së paku në baza vjetore, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës. Kur të vlerësojë të nevojshme, BQK rezervon të drejtën të kërkojë nga bankat që të testojnë planin.
2. Plani rezervë është pjesë e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:
- a. ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësive dhe vendimmarrjes në lidhje me vënien në zbatim të planit;
  - b. treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për zhvillimin e kushteve të jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave përgjegjës brenda bankës për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve;
  - c. kushtet në të cilat do të zbatohet plani;
  - d. përcaktimin e veprimtarive që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprimtari duhet të ndërmerren;
  - e. komunikimin me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun;
  - f. të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për zbatimin e planit.

3. Në kushte të situatave të vështirësive ekonomiko-financiare, banka bashkëpunon ngushtë me BQK-në dhe shkëmben informacion të vazhdueshëm me të mbi gjendjen e saj financiare, si dhe mbi veprimet e ndërmarra për rikthimin e saj në parametra të kënaqshëm.

### **KAPITULLI III**

#### **PARIMET, TREGUESIT DHE MASAT PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT**

##### **Neni 10**

#### **Elementet kryesore për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit**

1. Banka identifikon, vlerëson dhe menaxhon rrezikun e likuiditetit duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:
  - a. parimet e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit;
  - b. planifikimin dhe monitorimin e rrjedheve hyrëse dhe dalëse të parasë;
  - c. përcaktimin dhe ruajtjen e një strukture të përshtatshme të maturitetit;
  - d. monitorimin e burimeve të financimit dhe koncentrimin të tyre;
  - e. monitorimin e garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit;
  - f. monitorimin e linjave të financimit;
  - g. normat e likuiditetit.

##### **Neni 11**

#### **Parimet e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit**

1. Banka identifikon, vlerëson dhe menaxhon rrezikun e likuiditetit duke u bazuar minimalisht në parimet e mëposhtme:
  - a. parimin e mbështetjes në burime të qëndrueshme financimi;
  - b. parimin e minimizimit të hendekut të maturitetit kontraktual dhe hendekut të maturitetit sipas lëvizjeve reale;
  - c. parimin e diversifikimit të burimeve të financimit sipas llojit, monedhës, instrumenteve, maturimit, numrit të klientëve dhe tregjeve, duke konsideruar nivelin e likuiditetit të tyre;
  - d. parimin e zgjerimit të ekuilibruar/të kontrolluar të veprimtarisë dhe të ruajtjes së një vlere të mjaftueshme të aktiveve likuide;
  - e. parimet e disponueshmërisë së burimeve njerëzore për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit.

##### **Neni 12**

#### **Planifikimi dhe monitorimi i rrjedheve hyrëse dhe dalëse të parasë**

1. Banka parashikon dhe monitoron rrjedhën hyrëse dhe dalëse të fondeve për periudha të caktuara kohore, i cili duhet të jetë parashikim për një periudhe 1 (një) vjeçare. Ky parashikim konsideron të gjitha llojet e rrjedheve hyrëse dhe dalëse të parasë, duke përfshirë dhe rrjedhjet hyrëse dhe dalëse të parasë nga zërat jashtë bilancor. Banka duhet krahasuar këtë parashikim në intervale të rregullta, me vlerat aktuale të rrjedheve hyrëse dhe dalëse të parasë.



2. Parashikimet për rrjedhjet hyrëse të parasë përfshijnë së paku:

- a. shlyerjet aktuale të kredive (ku niveli i shlyerjeve nuk mund të jetë më i lartë se rrjedhjet hyrëse të kontraktuara të parasë, si dhe duke zbritur fondet rezervë të krijuara për humbjet e mundshme);
- b. konvertimin aktual në *cash* të aktiveve të cilat nuk kanë afat maturimi të përcaktuar;
- c. vlerat në *cash* të gjeneruara nga titujt e investimit;
- d. mundësitë aktuale të shitjes së aktiveve (ku investimet e kapitalit, kreditë me probleme dhe mjetet e qëndrueshme të trupëzuara trajtohen si aktive më pak likuide, duke përjashtuar rrjedhjet hyrëse të parasë nga ekzekutimi/et e kolateralit/ëve);
- e. rritjen e pritshme të depozitave;
- f. aftësinë e bankës për të siguruar fonde nga burime të tjera dhe disponueshmërinë e burimeve të tregut për financim;
- g. rrjedhjet tjera hyrëse të parasë, bazuar në analizën e të dhënave historike mbi nivelet dhe ecurinë e rrjedhjeve hyrëse të parasë në periudhat e mëparshme, duke patur parasysh veçoritë e operacioneve të bankës, ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.

3. Parashikimet për rrjedhjet dalëse të parasë përfshijnë së paku:

- a. detyrimet që maturohen;
- b. rritjen e ardhshme të nivelit të kredihënies së bankës;
- c. nivelet e depozitave dhe detyrimeve të tjera të qëndrueshme bazuar në luhatshmërinë e zakonshme të tyre dhe njohjen e sjelljes dhe interesave të depozituesve;
- d. depozitat me afat që mund të tërhiqen para afatit të maturimit dhe depozitat pa afat;
- e. ndikimin e ndryshimit të normës së interesit në nivelin e depozitave;
- f. nivelin e koncentrimit të depozitave;
- g. rrjedhjet dalëse të parasë nga zërat jashtë bilancor;
- h. rrjedhjet tjera dalëse të parasë bazuar në analizën historike të të dhënave mbi nivelin dhe ecurinë e rrjedhjeve dalëse të parasë në periudhat e mëparshme, duke patur parasysh ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.

### Neni 13

#### **Përcaktimi dhe ruajtja e një strukture të përshtatshme maturiteti**

1. Bankat duhet të monitorojë në baza mujore strukturën e maturitetit të mjeteve dhe detyrimeve me qëllim identifikimin *hendeqeve* të mundshme të maturitetit.
2. Banka, për qëllime të matjes dhe monitorimit të *hendeqeve*, klasifikon rrjedhjet hyrëse dhe dalëse të parasë nga aktivet (të drejtat), pasivet (detyrimet) dhe zërat jashtë bilancor, sipas intervaleve të maturimit.
3. Banka përdor si datë të arkëtimit të mjeteve datën më të fundit të mundshme të arkëtimit, dhe si datë të shlyerjes së detyrimeve datën më të parë të mundshme të shlyerjes sipas intervaleve të mëposhtme:

- a. deri në 7 ditë,
  - b. 7 ditë deri në 1 muaj,
  - c. 1 muaj deri në 3 muaj,
  - d. 3 muaj deri në 6 muaj,
  - e. 6 muaj deri në 12 muaj.
4. Banka kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e *hendeqeve* sipas maturitetit të mbetur të pritshëm, duke përdorur për këtë qëllim parashikime rreth rrjedhjeve të pritshme hyrëse dhe dalëse të parasë, si për shembull ndër të tjera probabilitetin e mbledhjes së mjeteve në momentin kur ato maturohen, probabilitetin e tërheqjes së depozitave përpara maturimit.
  5. Banka, në kuadrin e parashikimit të rrjedhjeve të ardhshme të parasë, sigurohet që supozimet e aprovuara të jenë të arsyeshme, të përshtatshme, të dokumentuara dhe të rishikuara në mënyrë periodike.
  6. Banka në përcaktimin e maturitetit të mbetur të mjeteve dhe detyrimeve, duhet:
    - a. të disponojë një bazë të të dhënave të rrjedhjeve hyrëse dhe dalëse të parasë mbi të cilat janë mbështetur supozimet;
    - b. të rishikojë në baza të rregullta supozimet e përdorura me qëllim pasqyrimin në këto të fundit të ndryshimeve të mundshme në kushtet e brendshme dhe të jashtme; si dhe
    - c. të sigurojë që supozimet të marrin në konsideratë karakterin sezonal dhe ciklik të rrjedhjeve hyrëse dhe dalëse të parasë.
  7. Banka, sipas metodologjisë së miratuar, mund të klasifikojë (grupojë) rrjedhjet e parasë sipas llojit të klientit, maturitetit, monedhës, sektorit, etj.
  8. BQK-ja mund të kërkojë aplikimin e supozimeve të ndryshme apo të faktorëve korigjues në parashikimin dhe monitorimin e rrjedhjeve të parasë sipas maturitetit të pritshëm, në rast se gjykon se këto veprime mundësojnë një pasqyrim më të mirë të profilit të rrezikut të bankës.
  9. Banka kryen analizën e *hendeqeve* të likuiditetit duke u mbështetur kryesisht në kriteret e mëposhtme:
    - a. klasifikimin e aktiveve, detyrimeve dhe zërave jashtë bilancor sipas maturitetit;
    - b. vlerësimin e qëndrueshmërisë së depozitave bazuar në të dhënat historike dhe rezultatet e *stress test*-eve;
    - c. vendosjen e limiteve për hendeqet e likuiditetit;
    - d. përlllogaritjen e *hendeqeve* në baza mujore dhe sipas valutave me ndikim të theksuar në likuiditetin e bankës;
    - e. parashikimin e *hendeqeve* të likuiditetit në të ardhmen;
    - f. çdo kriter tjetër që vlerësohet si i arsyeshëm

**Neni 14**  
**Monitorimi i burimeve të financimit dhe koncentrimi i tyre**

1. Banka monitoron në mënyrë periodike burimet e financimit me qëllim ruajtjen e një baze të diversifikuar të këtyre burimeve si dhe identifikimin e koncentrimëve të mundshme. Koncentrimet analizohen sipas burimit të financimit, llojit të financimit, tregut, koncentrimin gjeografik, monedhës dhe sipas maturitetit.
2. Monitorimi i burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre përfshin:
  - a. ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozitorët e mëdhenj, bankat korrespondente, klientët e tjerë të rëndësishëm, si dhe me partnerët e biznesit;
  - b. përcaktimin e qëndrueshmërisë së depozitave, duke marrë në konsideratë karakteristikat e depozituesve dhe llojin e depozitës;
  - c. monitorimin e nivelit të diversifikimit të burimeve të financimit;
  - d. përcaktimin dhe monitorimin e lëvizjeve në burimet e tjera të financimit.
3. Banka përcakton dhe monitoron nivelin e koncentrimin të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat në monedhën Euro dhe në monedhë të huaj.

**Neni 15**  
**Monitorimi i garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit**

1. Banka monitoron madhësinë/vlerën e garancive (kolateralit) të saj, me qëllim bërjen e dallimit në mes të mjeteve të vendosura si garanci (kolateral) dhe mjeteve të lira.
2. Monitorimi efektiv i garancive (kolateralit) synon përmbushjen e një tërësie kërkesash për kolateral lidhur me sigurimin e likuiditetit afatgjatë, afatshkurtër apo ditor.
3. Banka duhet të zotërojë madhësi të mjaftueshme të garancive (kolateralit) me qëllim përmbushjen e nevojave të pritshme apo të paparashikuara për huamarrje në tregun financiar, në tregun ndërbankar dhe nga BQK-ja, mbështetur mbi profilin e saj të financimit

**Neni 16**  
**Monitorimi i linjave të financimit**

1. Banka vlerëson mundësinë e rinegociimit të mundshëm të linjave të financimit dhe mundësinë që siguresit e fondeve të reagojnë në mënyrë të njëjtë edhe në rrethana/kushte jo të zakonshme.
2. Banka merr në konsideratë probabilitetin e shterimit të mundësive për linja financimi në rrethana jo të zakonshme.
3. Banka nuk mund të supozojë rinegociimin automatik të sigurt në masën 100 % (njëqind për qind) të linjave me afat maturimi njëditor.

## **Neni 17**

### **Normat e likuiditetit**

1. Banka mban likuiditetin në një shumë, strukturë dhe norma që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, me një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal.
2. Banka harton dhe zbaton procedurat e nevojshme për matjen dhe monitorimin e rrjedhës neto të parasë, si dhe për monitorimin e likuiditetit në valutat kryesore dhe në total.
3. Banka përllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkrutëra:
  - a. valutën Euro dhe valutën e huaj në nivelin minimal 20% (njëzet përqind) dhe
  - b. valutat totale në nivelin minimal 25 % (njëzet e pesë përqind)
4. Në përllogaritjen e mjeteve likuide përfshihen zërat e mëposhtëm:
  - a. paraja e gatshme;
  - b. llogaria me BQK-në;
  - c. llogaria me bankat në Kosovë me maturitet deri në 30 (tridhjetë) ditë;
  - d. bonot e thesarit të emtuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës të regjistruara në bilance të gjendjes si: “të tregtueshme apo për shitje”;
  - e. 80 % ( tetëdhjetë përqind) të obligacioneve të emtuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës të regjistruara në bilance të gjendjes si: “të tregtueshme apo për shitje”;
  - f. “Investimet“ në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës (bono thesari dhe obligacione) me maturitet të mbetur deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë;
  - g. bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë;
  - h. llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare;
  - i. depozitat me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturitet të mbetur deri në 30 (tridhjetë) ditë;
  - j. kredit për bankat dhe institucionet tjera financiare me maturitet të mbetur deri në 30 (tridhjetë) ditë;
  - k. letrat me vlerë të tregutëshme të emtuara nga qeverit qendrore dhe/ose bankat qendrore dhe me vlerësim nga agjencitë ndërkombtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P jo më pak se AA-;
  - l. letrat me vlerë të tregutëshme të emtuara nga institucionet financiare dhe me vlerësim nga agjencitë ndërkombtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P jo më pak se AA-;
  - m. plasmanët/letrat me vlerë të tregutëshme, që nuk janë të vlerësuara, por të emtuara nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit ( listuar në shtojcën 1);

- n. “Investimi” letrat me vlerë me maturitet të mbetur 30 (tridhjetë) ditë, (duke përjashtuar letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshira në paragrafin 4 (f) të nenit 17);
- o. Titujt e blerë sipas marrëveshjes së riblerjes (REPO), kur maturiteti i mbetur i riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë.
5. Mjetet (aktivet) e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “k”, “l”, and “m” nga pragrafi 4 i këtij Neni, konsiderohen mjete (aktive) me likuiditet të lartë.
6. Të gjitha mjetet (aktivet) likuide të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij Neni, do të përfshihen si të tilla vetëm në rastin kur mbi to nuk ekziston asnjë marrëveshje ose angazhim, i cili kufizon aftësinë e bankës për t’i zotëruar ato lirisht dhe në mënyrë të pavarur në rast nevojë, aktualisht dhe në të ardhmen, përveç rezervës së kërkuar të likuiditetit të BQK-së.
7. Bankat përfshijnë në treguesin e mjeteve (aktive) likuide, zërat e përcaktuar në nënparagrafët “h”, “i”, “j”, “n” dhe “o” të paragrafit 4 të këtij Neni, duke përdorur haircut-et e përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Klasifikimi i palëve jorezidente sipas S&P ose të barasvlefshëm me të	Shkurtim (Haircut)
1	<b>mbi BBB- *</b>	<b>0%</b>
2	<b>BB+</b>	<b>10%</b>
3	<b>BB</b>	<b>20%</b>
4	<b>BB-</b>	<b>30%</b>
5	<b>B+</b>	<b>40%</b>
6	<b>B</b>	<b>50%</b>
7	<b>B-</b>	<b>60%</b>
8	<b>nën CCC+ *</b>	<b>100%</b>

**Shënim sqaruese: \*përfshirë: BBB-; \*përfshirë CCC+.**

8. Mjetet (aktivet) likuide përfshihen në baza neto, duke përjashtuar interesin e përllogaritur dhe duke zbritur fondet rezervë dhe në rastin e vlerësimeve nga agjenci të ndryshme ndërkombtare të rating-ut për titull (letra me vlerë), do të merret për bazë vlerësimi më i ulët.
9. Në përllogaritjen e detyrimeve afatshkurtra, përfshihen të gjitha detyrimet me afat maturimi të mbetur deri në 1 (një) vit, përveç letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes si dhe të depozitave nga palët e treta të bllokuara si kolateral/garanci në bazë të një marrëveshjeje të caktuar me bankën. Në rastin e degës së bankës së huaj, në përllogaritjen e detyrimeve afatshkurtëra nuk përfshihen detyrimet ndaj bankës mëmë me afat të mbetur maturimi mbi 1 (një) muaj.
10. Banka, përveç treguesit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij Neni, monitoron dhe përcakton kur e gjykon të nevojshme limite të brendshëm edhe për treguesit e mëposhtëm:

- a. hendeku kumulativ deri në 1 (një) muaj ndaj mjeteve (aktiveve) likuide;
- b. hendeku kumulativ deri në 3 (tre) muaj ndaj mjeteve (aktiveve) likuide;
- c. raporti kredi ndaj depozitave (të përlllogaritura në total si dhe sipas valutave: në Euro dhe valuta të huaja);
- d. raporti kredi ndaj depozitave me linja të financimit;
- e. raporti i mjeteve (aktiveve) likuide ndaj totalit të depozitave;
- f. raporti i parave të gatshme (cash-it) ndaj detyrimeve afatshkurtëra;
- g. raporti i likuiditetit sipas intervaleve të maturitetit;
- h. treguesi i koncentrimit të depozitave ( sipas llojit të depozitave, valutës, sektorit, etj.) si dhe qëndrueshmëria e tyre;
- i. limitet e depozitave tek institucionet tjera financiare;
- j. parashikimi i nevojave të ardhëshme për likuiditet ( mjete likuide të disponueshme – mjetet likuide të kërkuara).

## **KAPITULLI IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRUNDIMATARE**

### **Neni 18**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkeljet e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve të parashikuara në Nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për Bankat.

### **Neni 19**

#### **Dispozita Kalimtare**

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të rishikojnë dhe/ose aprovajnë politikat dhe procedurat e brendshme në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

### **Neni 20**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Sejdi Rexhepi

## **Shtojca 1.**

Lista e Bankave Multilaterale Zhvillimore:

- a. Banka Ndërkombtare për Rindërtim dhe Zhvillim;
- b. Korporata Ndërkombtare Financiare;
- c. Banka Inter-Amerikane Zhvillimore;
- d. Banka Aziatike Zhvillimore;
- e. Banka Afrikane Zhvillimore;
- f. Këshilli i Bankave Europiane Zhvillimore;
- g. Banka Nordike Investive;
- h. Banka Karabiane Zhvillimore;
- i. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- j. Banka Evropiane Investive;
- k. Fondi Evropian Investiv;
- l. Agjencioni Multilateral Investiv i Garancioneve;
- m. Lehtësit Financiare Ndërkombtare për Përrjashtime;
- n. Banka Islamike Zhvillimore.